REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit: 01
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No: 05-8577
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages: - 28 -
Data: / Datum: / Date: 29/12/2023
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr.234/XII/2023
Datë:28.12.2023

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), nenin 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës , bazuar në Shtojcën 1 , pika 6.1 Rregullores (QRK) - nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

I. Aprovohet Plani veprimit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në kujdesin dytësor shëndetësor - 2024;

II. Shtojce e këtij vendimi është, Plani i Veprimit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në kujdesin dytësor shëndetësor – 2024;

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Dr. Arben Vitia
Ministër i Shëndetësisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA - MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH - Prishtinë / a

Vendim i dërgohet:

- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamenti ligjor;*
- *Arkivit të MSh.*

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njesia Org.
Org Jedinica
Org Unit 06
Nr.Prot:
Broj Prot:
Prot.No 05-8342
Nr.i faqeve
Br.stranica
No.pages -28-
Data:
Datum:
Date: 21/12/2023
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva – Ministry of Health

PËR/ZA/TO:		Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë			
PËRMES/PREKO/THROUGH		Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm			
CC:					
NGA/OD/FROM:		Niman Bardhi, Zv. Drejtor i DZHSSH dhe Kryesues i GP për hartimin e Planit të Veprimit dhe Programin për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Kërkesë për aprovim të Planit të Veprimit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në kujdesin dytësor shëndetësor - 2024			
Nr. i zyrës: **Br. kancelarije:** **Room No.:**	109	**Lokacioni:** **Kucni:** **Extension:**	MSh	**Data:** **Datum:** **Date:**	20/12/2023
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					☐
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					☒
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					☒
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					☐
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS					☐
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					☐
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					☐
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					☐
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					☐
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					☐

I nderuar Ministër i Shëndetësisë Dr. Arben Vitia,

Në cilësinë e Zv. Drejtorit të DZhSSh dhe Kryesues i GP për hartimin e hartimin e Planit të Veprimit dhe Programin për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension, ju njoftoj se me Vendim të Sekretarit të Përgjithshëm në MSh me nr. 616/X/2023, datë 13.10.2023 dhe nr. protokolli 05-6460, datë 16.10.2023 ka formuar grupin punues për hartimin e Planit të Veprimit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension. Grupin punues ka hartuar dhe finalizuar Planin e Veprimit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në kujdesin dytësor shëndetësor - 2024, andaj rekomandojmë aprovimin e këtij PV.

Të bashkëngjitur gjeni:

1. Plani i Veprimit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në kujdesin dytësor shëndetësor – 2024;
2. Kostimi i Planit të Veprimit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në kujdesin dytësor shëndetësor - 2024
3. Vendimin e grupit punues për hartimin e Planit të Veprimit dhe Programin për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension, me nr. prot. 05-6460, datë 16.10.2023.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë – Ministry of Health – Ministarstvo Zdravstva

Plani i veprimit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në kujdesin dytësor shëndetësor - 2024

Prishtinë, 2023

Shkurtesat

DM	Diabeti Melit
HTA	Hipertensioni
IHS	Projekti Shërbime te Integruara Shëndetësore
ISh	Institucionet Shëndetësore
KPSh	Kujdesi Parësor Shëndetësor
KDSh	Kujdesi Dytësor Shëndetësor
MSh	Minsitria e Shëndetësisë
SDC	Agjencioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SHSKUK	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës.
SP	Spitali i Përgjithshëm
Swiss TPH	Instituti Zviceran për Shëndet Publik dhe Sëmundjet Tropikale

Përmbajtja

1. Përmledhja Ekzekutive 4
2. Hyrje 5
3. Qëllimi 7
4. Objektivat 7
8. Hapësirat Spitalore: 9
9. Burimet Njerëzore 9
10. Programet e Trajnimit 9
11. Aplikacionet dhe mjetet digjitale 11
12. Modaliteti i zbatimit dhe planifikimi 11
13. Financimi dhe kostot 11
14. Monitorimi dhe vlersimi i programit 12
15. Zbatuesi 13

1. Përmledhja Ekzekutive

Programi për Vetë-Menaxhimin e Pacientëve me Diabet dhe Hipertension synon të përmirësojë kujdesin shëndetësor për pacientët në nevojë, duke u përqendruar në edukimin dhemonitorimin e tyre në distancë. Ky program synon të sigurojë një qasje të përmirësuar për pacientët, duke përfshirë përdorimin e aplikacioneve dhe pajisjeve digjitale për monitorim në distancë.

Qëllimi kryesor i programit është të ofrojë një qasje më efektive për menaxhimin e sëmundjeve kronike si diabeti dhe hipertensioni. Kjo do të realizohet përmes identifikimit dhe përzgjedhjes së pacientëve për përfshirje në program, ofrimit të njohurive dhe aftësive për menaxhimin e sëmundjeve, përdorimit të pajisjeve dhe aplikacioneve digjitale për monitorim në distancë, si dhe përmirësimit të bashkëpunimit mes niveleve të kujdesit shëndetësor.

Kriteret për përfshirjen e pacientëve janë të përcaktuara në kategori të ndryshme duke përfshirë kritere klinike, diagnostike, demografike dhe sociale. Programi synon të përmirësojë cilësinë e kujdesit shëndetësor për popullatën, veçanërisht për grupet e margjinalizuara që kanë kufizim në qasje në shërbimet shëndetësore.

Trajnime të specializuara do të ofrohen për profesionistët shëndetësor dhe pacientët, fokusuar në menaxhimin e sëmundjes, rëndësinë e aktivitetit fizik, dietën, përdorimin e pajisjeve dhe aplikacioneve për monitorim në distancë.

Pacientët do të përdorin aplikacione dhe pajisje digjitale për të monitoruar parametrat e tyre shëndetësorë dhe për të raportuar ato tek profesionistët shëndetësorë. Ky program synon të përmirësojë bashkëpunimin mes niveleve të kujdesit shëndetësor dhe të sigurojë një përvojë kohezive për pacientët brenda sistemit shëndetësor.

Hapësirat në spitalet partner do të përdoren për aktivitete të ndryshme si edukimi i pacientëve, monitorimi në distancë dhe vizitat e tyre. Përveç kësaj, do të ketë staf të dedikuar për zbatimin e këtij programi në nivel lokal.

Financimi i prgramit do të realizohet nga projekti HIS, ndërsa MSh është Institucioni udhëheqës. Programi do të fillojë si një fazë pilot për testimin e efikasitetit dhe pastaj do të zgjerohet në Institucionet e tjera.

Për suksesin e programit, do të kryhet një monitorim i vazhdueshëm i rezultateve shëndetësore të pacientëve dhe vlersime periodike të efikasitetit të programit. Ky program do të zbatohet në bashkëpunim me Institucionet KPSh dhe KDSh për të siguruar një kujdes shëndetësor sa më cilësor dhe të qëndrueshëm për pacientët me diabet dhe hipertension në Kosovë.

Në përpjekjen për të zvogëluar barrën e sistemit shëndetësor dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së pacientëve, ky program siguron një qasje inovative dhe të përballueshme për të gjithë ata që vuajnë nga këto sëmundje kronike. Nëpërmjet përdorimit të teknologjisë dhe trajnimeve të dedikuara, synohet të sigurohet një mënyrë efikase e trajtimit dhe monitorimit, duke theksuar në edukimin e pacientëve për vetë-menaxhimin e tyre.

2. Hyrje

Menyrat e monitorimit te pacienteve në distance " ju mundeson profesionisteve shëndetësorë te monitorojnë sëmundjen dhe progredimin e simptomave nga distanca dhe më pas angazhimin virtual me pacientet për të modifikuar planet e kujdesit dhe për të ofruar edukim për vetë-menaxhim, bazuar në ndryshimet e gjendjes se pacienteve"[1]

Menyrat e monitorimit nga distanca sjellin përfitimet e mëposhtme për pacientët, sistemin shëndetësore, profesionistet shëndetësor dhe shoqërinë ne pergjithesi:

Mundeson shkëmbim te vazhdueshem të informacioneve ndërmjet pacientëve dhe profesionistëve shëndetësor, qe rezulton në percjelljen më të afërt të gjendjes se pacientit, si dhe ndërhyrjet klinike dhe teknike të sakta dhe me kohë.[2]

Kjo është veçanërisht e rëndësishme tek semundjet kronike pasi qe nje monitorim i vazhdueshem nga distanca mundeson parandalimin e përkeqësimeve te atyre gjendjeve apo edhe perfundimet fatale.[3]

Pacientët me DM dhe HTA, tek të cilët aplikohet monitorimi ne distance, kanë treguar reduktim të konsiderueshëm të HbA1c, përmirësim te cilesise së jeteses, menaxhim me te pamvarur te semundjes, qasje me te lehte në kujdesin shëndetësor dhe reduktim te pabarazive.[4]

Poashtu rezultojnë të jenë efektive dhe shpesh alternativë e përshtatshme për grupet e margjinalizuara që përballen me kufizime në qasje ne institucionet shendetesore për shkak të distancës gjeografike, moshës, kushteve fizike ose kufizimeve kohore,uljen e kostove, numrit te hospitalizimeve dhe qëndrimit në spital.[5]

Bazuar në analizën e statistikave të pacientëve të hospitalizuar në Spitalet e Përgjithshme në Gjakovë dhe Pejë në një periudhë 6-mujore, është evidentuar se shumica e pacientëve që shtrihen ne spital më shumë se dy herë brenda kesaj periudhe, perveç DM dhe HTA, vuajnë edhe nga sëmundje të tjera si rezultat i komplikimeve të semundjeve bazë.

Me qëllim të evitimit te hospitalizimeve te shpeshta, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, parandalimin e komplikimeve të hershme të DM dhe HTA, në përputhje me kërkesat dhe rekomandimet e profesionistëve shëndetësorë të këtyre dy spitaleve, propozojmë që të zhvillohet programi i monitorimit ne distance i cili perkrah pacientet per vete-menaxhim te

---

[1] HIMSS. Remote Patient Monitoring: COVID-19 Applications and Policy Challenges. Accessed November 28, 2021. https://ëëë.himss.org/neës/ remote-patient-monitoring-covid-19

[2] Health Advances. The Changing Fortunes of Telemedicine in Europe – Past, Present, and Future beyond COVID-19. Published May 6, 2022. Accessed February 15, 2022. https://healthadvancesblog.c

[3] Dinesen B, Haesum LKE, Soerensen N, et al. Using preventive home monitoring to reduce hospital admission rates and reduce costs: a case study of telehealth among chronic obstructive pulmonary disease patients. Journal of Telemedicine and Telecare. 2012;18 (4). doi:10.1258/jtt.2012.110704

[4] Bond CS, Ëorsëick L. Self Management and Telehealth: Lessons Learnt from the Evaluation of a Dorset Telehealth Program. Patient. 2015;8(4):311-6. doi:10.1007/s40271-014-0091-y. PMID: 25315192

[5] Centers for Disease Control and Prevention. Using Telehealth to Expand Access to Essential Health Services during the COVID-19 Pandemic.; 2020. Accessed November 26, 2021. https://ëëë.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/hcp/telehealth.htm

semundjes se DM dhe HTA permes edukimit shendetesor, paisjeve dhe aplikacioneve te dedikuara per kete qellim.

Hartimi i këtij plani të veprimi për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në kujdesin dytësor shëndetësor (KDSh) është angazhim i përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë (MSh)dhe partnereve strategjik, Projektit "Shërbimet Shëndetësore të Integruara" (IHS), projekt ky i financuara nga SDC (Agjencioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim) dhe i zbatuar nga Swiss TPH (Instituti Zviceran për Shëndet Publik dhe Sëmundjet Tropikal).

Plani i veprimit është hartuar nga grupi punues gjithëpërfshirës (MSh-së, KPSh, KDSh, ekspertët e angazhuar nga IHS) të emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i MSh.

3. Qëllimi

Programi për Vetë-Menaxhim te Pacientëve me DM dhe HTA në Kosovë ka për qëllim qasjen në kontrollin, parandalimin e komplikimeve si dhe përmiresimin e kualitetit te jetesës përmes edukimit dhe monitorimit në distancë. Ky program përfshin në mënyrë aktive pacientët për të menaxhuar më mirë shëndetin e tyre nën monitorimin e vazhdueshem nga profesionistët shëndetësor.

4. Objektivat

- Të bëhët identifikimi dhe përzgjedhja e pacientëve që i plotësojnë kriteret për përfshirjen në program.
- Të ju ofrojë pacientëve njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për vetë-menaxhimin e DM dhe HTA.
- Të sigurohen mjetet dhe të implementohen aplikacionet digjitale për vetë-menaxhim dhe monitorim në distancë.
- Të përmirësohet bashkëpunimi mes të nivelit parësor dhe dytësor shëndetësorë.
- Të rritet cilësia e kujdesit shëndetësor për popullatën e margjinalizuar.

5. Rëndësia e Hartimit të Programit

- Ky program do të sigurojë që pacientët të marrin njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të menaxhuar më mirë DM dhe HTA. Kjo do të çojë në përmirësimin e shëndetit të tyre , zvogëlimin e rrezikut të komplikimeve serioze dhe shpenzimeve shëndetësore.
- Duke përmirësuar menaxhimin e DM dhe HTA në nivelin komunitar, programi do të ndihmojë në zvogëlimin e hospitalizimeve të shpeshta , uljen e ngarkesës se sistemin shëndetësor ,lirimin e hapsirave te nevojshme për pacientët në gjendje më të rënduar shëndetësore.
- Ky program mundëson monitorim në distancë të pacientëve, për të siguruar perçjellje të vazhdueshme të gjendjës së tyre shëndetësore.
- Ky program fuqizon pacientët për të marrë kontrollin mbi shëndetin e tyre nëpërmjet edukimit shëndetësorë dhe për përdorimin e pajisjeve, e cila do t'ju mundesoj ndjekjën e planit individual te menaxhimit.
- Ky program ndihmon në përmirësimin e bashkëpunimit ne mes te nivelit parësorë dhe dytësor kujdesit shëndetësor, që do të sigurojë që pacientët të kenë një përvojë kohezive dhe të koordinuara në sistemin shëndetësor.
- Ky program poashtu siguron që edhe ata që janë në rrezik më të madh ose kanë më pak qasje në kujdesin shëndetësor të kenë mundësi të njëjta për menaxhimin e DM dhe HTA.

6. Metoda e Monitorimit në Distancë

Monitorimi në distancë do të bëhet përmes mjeteve digjitale dhe aplikacioneve të specializuara që do të ju mundësojnë pacientëve të monitorojnë parametrat e tyre shëndetësorë dhe t'i ndajnë ato me ekspertët shëndetësorë. Disa nga metodat e monitorimit në distancë përfshijnë:

- Pajisje për matjen e glikemisë në gjak, presionit të gjakut dhe pulsit.
- Monitorimi i aktivitetit fizik dhe menyra e të ushqyerit.

7. Kriteret për Përfshirjen e Pacientëve.

Për të siguruar që programi të përfshijë pacientët e duhur, janë vendosur kritere të caktuara për përfshirjen e tyre. Këto kritere janë të ndarë në katër kategori:

7.1. Kriteret Klinike:

1. Diabet i pakontrolluar
2. Hipertension i pa kontrolluar
3. Pacientët rezistent ndaj terapisë diabetike dhe hipertensive.
4. Pacientët me komplikime kronike te avancuara të diabetit siç janë: komplikimet mikrovaskulare (retinopatia, nefropatia dhe neuropatia diabetike) dhe komplikimet makro vaskulare (shputa diabetike, semundjet ishemike te zemres - SKV, cerebrovaskulare dhe arterieve periferike)
5. Pacientët që kanë nevojë për trajtim të specializuar në nivel më të lartë për shkak të komplikimeve të DM ose HTA.

7.2. Kriteret Diagnostike:

1. Pacientët me nivele të larta të glikemisë në gjak (Glikemia mbi 16 mmol) me vështirësi në kontrollimin e glikemisë.
2. Pacientët që kanë vlerat e HbA1c mbi 10%.
3. Shtypja e gjakut e pa kontrolluar më e lartë se 160/100
4. BMI / IMT mbi 40 ose mbi 35 nëse është i lidhur me komorbiditete.
5. Pacientët në rrezik për hipoglikemi (krizë hipoglikemike brenda vitit, ose hipoglikemi pa shenja paralajmeruese).
6. Humbja në peshë (element për ketozë dhe ketoacidozë).
7. Shenjat dhe simptomat e neuropatisë (dhimbje e madhe e këmbëve, humbja e ndjeshmërisë së këmbëve).
8. Pacientët në rrezik për shfaqjen e shputës diabetike.
9. Ndryshimet në EKG (shenja të hipertrofise së ventrikulit të majt).
10. Dislipidemi.

7.3. Kriteret Demografike:

1. Pacientët e hospitalizuar më shumë se dy herë brenda 6 muajve.
2. Pacientët të cilët kanë faktorë të lartë të rrezikut, histori pozitive për SKV, obezitet dhe diabet.
3. Pacientët me sëmundje të rënda të tjera kronike (komorbiditet) që kërkojnë kujdes të veçantë, si hipertensioni, sëmundjet kronike të veshkave, sëmundjet kardiovaskulare, hiperlipidemia, etj.

7.4. Kriteret Sociale:

1. Pacientë të cilët janë vulnerabël dhe me qasje të kufizuar në shërbimet shëndetësore.
2. Pacientë me lëvizje të kufizuar dhe probleme në të pamur.
3. Pacientë nga komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptian.
4. Pacientë te aftë për të përdorur pajisje teknologjike apo me anëtarë të familjes që mund t'i asistojnë ata në përdorimin e pajisjeve digjitale.
5. Pacientë të cilët nuk kanë njohuri rreth sëmundjes së diabetit dhe hipertensionit dhe kanë nevojë për edukim shëndetësor.

Pacientët duhet të plotësojnë të paktën 8 nga 23 kriteret për të qenë të kualifikuar për programin.

I. Kriteret Klinike (duhet të plotësohen të paktën 2)
II. Kriteret Diagnostike (duhet të plotësohen të paktën 3)
III. Kriteret Demografike (duhet të plotësohet të paktën 1)
IV. Kriteret Sociale (duhet të plotësohen të paktën 2)

8. Hapësirat Spitalore:

Për zbatim te këtij programi janë të dedikuara hapësirat e nevojshme brenda spitaleve partner për aktivitete të ndryshme, përfshirë dhomën për edukimin e pacientëve, hapsira për pajisjet për monitorimin në distancë dhe vizitat e pacientëve.

9. Burimet Njerëzore

Dy infermierë nga repartet e mjekësisë interne të spitaleve partner do të caktohen për zbatimin e programit. Përveç kësaj, profesionistët e kujdesit parësor shëndetësor do të përfshihen ne trajnimet e përbashkëta për te realizuar vizitat ne teren te pacientet me SKJN.

10.Programet e Trajnimit

Do të zhvillohen programe trajnimi për profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe pacientët, me fokus në tema si menaxhimi i sëmundjes, terapia – dieta ushqimore, aktiviteti fizik dhe përdorimi i pajisjeve.

Trajnim do ju ofrohet profesionistëve shëndetësor te repartit internistik (mjek dhe infermier) dhe do të zhvillohet në spitale partner.

Programi do të përfshijë disa komponentë të rëndësishëm:

10.1. Modulet trajnuese për profesionistët shëndetësor janë:

- Shkathtësitë e komunikimit
- Informatat rreth sëmundjes
- Rëndësia e matjes/monitorimit te parametrave (Glikemia, Frymemarrja, TA, Pulsi, Saturimi…)
- Dokumentimi /evidentimi i sakt i vlerave te glikemisë dhe TA
- Udhëzime për menaxhimin e barnave/administrimi i barnave- zbatimi i udherrefyesit per trajtim farmkologjik te DM dhe HTA dhe protokoleve perkatese te trajtimit- te aprovuara nga Ministria e Shendetesise.
- Udhëzime për mënyrën e rimbursimit për barnat.
- Rëndësia e stilit te drejt te jetës (aktiviteti fizik, ushqyeshmëria e drejte, menaxhimi i stresit etj.)
- Reagimi ne raste emergjente/si te veprohet– veprimi hap pas hapi.
- Vlerësimi i rezultateve dhe monitorimi (te definohet a do formojmë grup te pacientëve te kontrollit)
- Edukimi i te rriturve/ instruksione si te mbahen sesionet këshilluese.
- Instruksionet për përdorimin e pajisjeve për monitorim ne distance, dokumentimi dhe monitorimi i rezultateve.

Kohëzgjatja e trajnimit: Realizimi i programit trajnues do te realizohet për 5 ditë

Mënyra e organizimit: Trajnimi do organizohet me grupe për shkak te specifikave te orarit te punës se profesionistëve shëndetësor dhe duke mos penguar procesin e punës ne institucionet spitalore.

Vendi: Trajnimi do realizohet në Qendrat e Mësimit ne Spitalet e Përgjithshme partnere.

Trajnuesit: Trajnuesit do përcaktohen nga projekti në bashkpunim me MSh.

10.2. Modulet trajnuese për pacientin dhe anëtarë e familjes:

- Informatat rreth sëmundjes.
- Rëndësia e vizitave te rregullta sipas rekomandimeve te mjekut.
- Rëndësia e matjes/monitorimit te parametrave.
- Evidentimi i saktë i vlerave te glikemisë dhe TA.
- Udhëzime për menaxhimin e barnave/administrimi i barnave.
- Udhëzime për mënyrën e rimbursimit për barnat.
- Rëndësia e stilit te drejt te jetës (aktiviteti fizik, ushqyeshmëria e drejte, menaxhimi i stresit).
- Instruksionet për përdorimin e pajisjeve për monitorim ne distance, dokumentimi dhe monitorimi i rezultateve.
- Reagimi ne raste emergjente/si me veprua.

Trajnimi: për pacientë dhe familjaret e tyre që jetojnë me pacientin do jetë një ditor.

Vendi: Trajnimi për pacientet do organizohet me grupet ndaras në Peje dhe Gjakovë.

Trajnuesit: do definohet nga Projekti HIS në bashkpunim me MSh (ekspert lokal me ekspertise klinike spitalore, një mjek dhe një infermiere)

Programet trajnuese: të detajuara do hartohen nga ekspertet qe do përzgjidhen për te mbajtur trajnimet.

Edukimi i Pacientëve:

Pacientët do të trajtohen sipas moduleve edukimi që përfshijnë:

- Informacion mbi sëmundjen dhe trajtimin.
- Terapinë ushqimore dhe dietën e duhur.
- Aktivitetin fizik dhe rëndësinë e tij.
- Parandalimin e komplikimeve të mundshme.
- Menaxhimin e stresit dhe rëndësisë së tij në shëndet.
- Përdorimin e mjeteve dhe aplikacioneve të monitorimit në distancë.

Shërbimi i udhëhequr nga infermierja: Pacientët që nuk kan mundësi për të qëndruar në spital do të kenë qasje në një shërbim të udhëhequr nga infermierja. Infermierja do të kujdeset për:

- Monitorimin e parametrave shëndetësore (glikemisë në gjak, presionit të gjakut, pulsit, temperaturës, dhe saturimit të oksigjenit).
- Sigurimin e trajtimit të duhur.
- Ndihmë në administrimin e barnave.
- Edukim për menaxhimin e sëmundjes.

11. Aplikacionet dhe mjetet digjitale

Pacientët do të përdorin aplikacione dhe mjete digjitale për të monitoruar dhe raportuar parametrat e tyre shëndetësorë. Këto mjete do të përfshijnë aplikacione për celularë që mund të matin dhe transmetojnë vlerat e glikemisë në gjak, tensionit arterial dhe pulsit.

Përmirësimi i Bashkëpunimit shëndetësor: Programi synon të përmirësojë bashkëpunimin mes niveleve të kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor. Kjo do të realizohet përmes trajnimeve dhe koordinimit të shërbimeve në të dy nivelet.

12.Modaliteti i zbatimit dhe planifikimi

Do të ketë një fazë pilot për testimin e efikasitetit dhe pastaj do të zgjerohet në mënyrë graduale në të gjithë spitalet e përgjithshme ne Kosovë.

13.Financimi dhe kostot

Programi është me financim të përbashkët nga donatori dhe Ministria e Shëndetësisë (burimet njerëzore, infrastruktura). Ky dokument përfshinë edhe planin e veprimit për vitin 2024 për të siguruar që programi të jetë i qëndrueshëm dhe i financuar në të ardhmen.

14. Monitorimi dhe vleresimi i programit

Suksesi i programit do të vlerësohet përmes monitorimit të rezultateve shëndetësore të pacientëve, përmes rritjes së vetë-menaxhimit dhe përmes raporteve të cilat do të jenë të disponueshme për institucionet shëndetësore dhe donatorin.

Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit do të bëhët nga grupi punues i emëruar me vendim nga Sekretari i Përgjithshem në MSh.

Realizimi i aktiviteteve për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Veprimit do të mundësojnë sigurimin e të dhënave të bazuara në dëshmi lidhur me arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë dokument. Qëllimi i monitorimit është ofrimi i raporteve lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit, sipas të dhënave zyrtare, të cilat do të shërbejnë për vendime të bazuara në dëshmi për MSH-në.

Bazuar në indikatorët kyç të definuar në Plan të Veprimit, monitoron indikatorët sipas periudhës dhe frekuencës së përcaktuar dhe raporton në MSH duke siguruar që institucionet dhe departamentet përgjegjëse të ofrojnë llogaridhënie në rast të moszbatimit të detyrave dhe aktiviteteve të planifikuara.

Ky proces do të ndikoj në ndryshimin dhe plotësimin vjetor të Planit të Veprimit. Parim udhëheqës gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit është gjithëpërfshirja, ku në proces të monitorimit dhe vlerësimit do të përfshihen të gjithë aktorët dhe institucionet hisedare në këtë fushë përmes shfrytëzimit të kapaciteteve institucionale, procedurave të brendshme dhe mekanizmave tjerë administrativë që lidhin dhe mundësojnë komunikimin e institucioneve shëndetësore mes vete. Në këtë proces, theksi është vënë në përdorimin e mekanizmave ekzistues për mbledhjen, agregimin, analizën dhe diseminimin e të dhënave në kuadër të Ministrisë dhe institucioneve tjera të përfshira. Ky dokument përfshin një numër të indikatorëve në nivele të ndryshme të zbatimit për periudhën kohore të përcaktuar në dokument, duke shfrytëzuar burime të informatave, raportime në periudha të rregullta përmes strukturave të përcaktuara të procesit të monitorimit.

Raportimi i zbatimit të aktiviteteve, sfidave eventuale dhe rekomandimet për ndryshime, do të jenë periodike dhe me kohë. Kjo do të mundësojë adresimin në kohën e duhur nga gjetjet e raporteve, për qëllim orientimin e politikave për shërbimet e ofruara në SP Gjakove dhe Pejë.

Rezultatet e pritura nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të mundësojnë edhe ofrimin e informatave kthyese efektive dhe me kohë për të gjitha grupet e interesit, ofrimin e raporteve të performancës së tyre, raportet fillestare ku janë të përcaktuara vlerat bazë të treguesve krahasuar me vlerat e pritshme dhe të dëshirueshme, raportet periodike të progresit si dhe raportet vjetore të performancës.

Vlerësimi përfundimtar i dokumentit do të ofroj të dhëna të bazuara në dëshmi të cilat do të shfrytëzohen si bazë për përcaktimin e kahjeve strategjike në periudhat e ardhshme si dhe hartimin e dokumenteve tjera në vazhdimësi. Raportimi i monitorimit të progresit, zbatimit dhe arritjeve të Planit të Veprimit do t'i prezantohet të gjitha institucioneve hisedare si dhe instancave përkatëse në baza të rregullta dhe kur është e nevojshme edhe publikut.

15. Zbatimi

Programi do të zbatohet ne dy Spitalet e përgjithshm në Gjakovë dhe Pejë ne mbështetje të plotë nga Ministria e Shëndetësisë dhe në bashkëpunim me SHSKUK. Zbatimi i këtij programi do te realizohet me facilitimin e projektit IHS.


Zbatimi i Planit të Veprimit paraqet sfidë institucionale për sektorin e shëndetësisë dhe të gjitha palët e përfshira, marrë parasysh burimet njerëzore në dispozicion si dhe burimet financiare.

Megjithatë, IHS permes MSh dhe ne bashkpunim me institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit për arritjen e objektivave, do të angazhohet dhe do të zbatojë një kombinim masash që përfshijnë përmirësimin e politikave dhe standardeve profesionale, promovimin dhe edukimin shëndetësor si mekanizëm për avancimin e shëndetit të qytetarëve në regjionin e Gjakoves, Pejes dhe më gjerë, ndërtimin e kapaciteteve të profesionistëve shëndetësor për intervenimet e bazuara në evidencë, sigurimin e kushteve infrastrukturore dhe pajisjeve në SP Gjakove dhe Peje.

PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në kujdesin dytësor shëndetësor - 2024						
Objektiva: Hartimi i programit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në Spitalin e Përgjithshëm Pejë dhe Gjakovë						
Rezultati: Funkcionalizimi i programit të vetë-menaxhimit të pacientëve me diabet dhe hipertension në Spitalin e Përgjithshëm Pejë dhe Gjakovë						
Aktiviteti 1 – Pacientet	**Afati i zbatimit**	**Kostoja totale 2024**	**Burimi financimit**	**Inst. udhëheqës**	**Inst. mbështetës**	**Produkti**
1.1 Identifikimi dhe përzgjedhja e pacientëve për përfshirjen në program.	TM1	1,000.00€	IHS	MSh	IHS,SP Pejë dhe Gjakovë	Lista e pacientëve të përfshirë
Aktiviteti 2 – Paisjet	**Afati i zbatimit**	**Kostoja totale 2024**	**Burimi financimit**	**Inst. udhëheqës**	**Inst. mbështetës**	**Produkti**
2.1 Sigurimi i pajisjeve dhe softverit për monitorim në distancë të pacienteve me DM dhe HTA	TM1	10,000.00€	IHS	MSh	IHS,SP Pejë dhe Gjakovë	Softveri dhe pajisjet e siguruara
2.2 Vendosja e pajisjeve dhe softverit në hapsirat e përzgjedhura dhe mirëmajtja nga operatori ekonomik	TM1	10,000.00€	IHS	MSh	IHS,SP Pejë dhe Gjakovë	Pajisjet dhe softveri i alokuar në hapsirat e përzgjedhura
Aktiviteti 3 – Hapesirat	**Afati i zbatimit**	**Kostoja totale 2024**	**Burimi financimit**	**Inst. udhëheqës**	**Inst. mbështetës**	**Produkti**
3.1 Përzgjedhja e hapsirave adekuate për vendosjen e paisjeve dhe softverit per monitorim ne distancë	TM1	500.00€	IHS	MSh	IHS,SP Pejë dhe Gjakovë	Shenjëzimi i Hapsirës
3.2 Renovimi dhe adaptimi i hapsirave të përzgjedhura	TM1	5,000.00€	IHS	MSh	IHS,SP Pejë dhe Gjakovë	Hapsirat e renovuara dhe te adaptuara
Aktiviteti 4 – Burimet njerezore	**Afati i zbatimit**	**Kostoja totale 2024**	**Burimi financimit**	**Inst. udhëheqës**	**Inst. mbështetës**	**Produkti**
4.1 Përzgjedhja e dy infermierve nga repartet e mjekësisë interne të spitaleve partnere	TM1	BK	SP Gjakove dhe Peje	MSh	IHS	Emerimi i dy infermiereve
4.2 Përzgjedhja e dy infermierve nga QKMF në Pejë dhe Gjakovë.	TM1	BK	QKMF Gjakove dhe Peje	MSh	IHS	Emerimi i dy infermiereve
4.3 Përzgjedhja e dy mjekëve nga repartet e mjekësisë interne të spitaleve partnere	TM1	BK	QKMF Gjakove dhe Peje	MSh	IHS	Emerimi i dy mjekeve

Aktiviteti 5 – Trajnimet	Afati i zbatimit	Kostoja totale 2024	Burimi financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
5.1 Hartimi i programit trajnues (aplikimi për akreditim të pragramit në OMK dhe OIK)	TM1	5,000.00€	IHS	MSh	IHS, KPSH, SHSKUK, OMK, OIK	Manuali i trajnimit
5.2 Trajnimi i trajnerëve	TM1	5,000.00€	IHS	MSh	IHS, KPSH, SHSKUK, OMK, OIK	Trajner të Certifikuar
5.3 Trajnimi i stafit te internos ne SP Peje dhe te Infermiereve ne QKMF Peje qe realizojne vizitat ne shtepi	TM1 – TM4	3,000.00€	IHS	SP Peje dhe QKMF Peje	IHS, KPSH, SHSKUK, OMK, OIK	Stafi i trajnuar
5.4 Trajnimi i stafit te internos ne SP Gjakove dhe te Infermiereve ne QKMF Gjakove qe realizojne vizitat ne shtepi	TM1 – TM4	3,000.00€	IHS	SP Gjakove dhe QKMF Gjakove	IHS, KPSH, SHSKUK, OMK, OIK	Stafi i trajnuar
5.5 Trajnimi i pacienteve dhe familjareve per perdorimin e paisjeve ne spitalin e Gjakoves	TM1 – TM4	1,000.00€	IHS	SP Gjakove	IHS, KPSH, SHSKUK	Stafi i trajnuar
5.5 Trajnimi i pacienteve dhe familjareve per perdorimin e paisjeve ne spitalin e Pejes	TM1 – TM4	1,000.00€	IHS	SP Peje	IHS, KPSH, SHSKUK,	Stafi i trajnuar
Aktiviteti 6 – Monitorimi dhe vleresimi	**Afati i zbatimit**	**Kostoja totale 2024**	**Burimi financimit**	**Inst. udhëheqës**	**Inst. mbështetës**	**Produkti**
6.1 Hartimi i indikatorëve matës për monitorim dhe vlerësim	TM1	3,000.00€	IHS	MSh,SP Pejë dhe Gjakovë	IHS	Raporti periodik i monitorimit
6.2 Monitorimi dhe velërsimi i programit	TM1 – TM4	3,000.00€	IHS	MSh,SP Pejë dhe Gjakovë	IHS	Raporti periodik i monitorimit
6.3 Reflektimi i rekomandimeve te programit	TM4	2,000.00€	IHS	MSh	SP Pejë,IHS	Raporti final i vlerësimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm – Ured Generalnog Sekretara –Office of the General Secretary

Nr: 616 /X/2023
Datë:13.10.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Emërohet grupi punues për hartimin e Planit të Veprimit dhe Programin për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension, në këtë përbërje:

1. Niman Bardhi	MSh	kryesues
2. Merita Emini Sadiku	QKUK	zëvendës kryesuese
3. Zenel Hysenaj	MSh	anëtar
4. Besnik Ibraj	SP Pejë	anëtar
5. Qazim Avdimetaj	SP Pejë	anëtar
6. Teuta Goga	SP Pejë	anëtar
7. Arta Hyseni	SP Pejë	anëtar
8. Hilmi Shala	SP Gjakovë	anëtar
9. Galina Berisha	SP Gjakovë	anëtar
10. Labinot Fetoshi	SP Gjakovë	anëtar
11. Vjollca Krasniqi	SP Gjakovë	anëtar
12. Afërdita Hoxha	MSh	anëtar
13. Mentor Sadiku	MSh	anëtar
14. Arben Koshi	QKMF Gjakovë	anëtar
15. Leonora Bakija	QKMF Gjakovë	anëtar
16. Myrvete Salihi	QKMF Pejë	anëtar
17. Rajmonda Elshani	QKMF Pejë	anëtar
18. Idriz Ethemi	ShP me Diabet	anëtar
19. Agron Bytyqi	PRAK	anëtar

II. Grupi punues do të mbështet me ekspertizë nga Sophie Delaigue nga Projekti IHS si dhe me mbështetje profesionale dhe teknike nga Ilir Mecini dhe Fekrije Hasani.

III. Grupi punues Planin e Veprimit dhe Programin për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension, duhet të dorëzoj te Sekretari i Përgjithshëm deri në fund të Dhjetorit të vitit 2023;

IV. Shfuqizohet vendimi me nr.protokolli 05-3963 i datës 29.06.2023 dhe vendimi me nr.protokolli 05-3963/2 i datës 18.07.2023.

V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Dr. Naim Kadiqi

Sekretar i Përgjithshëm

Vendim i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Departamentit ligjor;*
- *DZhSSh;*
- *Arkivit të MSh-së.*

Niman Bardhi

From: Niman Bardhi
Sent: Monday, December 18, 2023 7:53 AM
To: Minire.Kazazi
Cc: Naim Bardiqi; Vjosa Kalaja; Besa Balidemaj; Kadrije Berisha
Subject: Kërkesë për kostim të PV për vetëmenaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension
Attachments: PV per Vetemenaxhim te pacienteve me diabet dhe hipertension (14.12.2023).docx

E nderuara kolege Minire,

Ju lutem të procedoni për kostim PV për vetëmenaxhim të pacientëve me diabet dhe hypertension.

Me respekt,

MSc.Niman Bardhi, PhDc.
Psikolog Klinik

Zv. Drejtor i Departamentit për Zhvillim Strategjik Shëndetësor

Ministria e Shëndetësisë

Email: niman.bardhi@rks-gov.net; nimanbardhi@gmail.com; nimanbardhi@hotmail.com.

Tel. zyre: +383 (0) 38 200 24 105

Tel. mob: +383 (0) 44 352 172; +383 (0) 49 352 172

From: Niman Bardhi
Sent: Thursday, December 14, 2023 11:31 AM
To: Arsim Qavdarbasha (Arsim.Qavdarbasha@rks-gov.net) <Arsim.Qavdarbasha@rks-gov.net>; Mentor Sadiku <Mentor.Sadiku@rks-gov.net>; Aferdita Syle Hoxha <aferdita.syle.hoxha@rks-gov.net>; Gjylferije Zabeli <Gjylferije.Zabeli@rks-gov.net>; Kadrije Berisha <Kadrije.Berisha@rks-gov.net>; Mentor Syla <Mentor.Syla@rks-gov.net>; Jahe Gecaj <jahe.gecaj@rks-gov.net>
Cc: Naim Bardiqi <Naim.Bardiqi@rks-gov.net>; Minire.Kazazi <Minire.Kazazi@rks-gov.net>; Vjosa Kalaja <Vjosa.Kalaja@rks-gov.net>
Subject: Njoftim

Të nderuar kolegë,

Me mirësi kërkoj nga ju të ofroni komentet tauaj lidhur me PV për vetëmenaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension. Të gjitha komentet tuaja i adresoni deri në fund të kësaj jave, në emailin tim zyrtar.

Me respekt,

MSc.Niman Bardhi, PhDc.
Psikolog Klinik

Zv. Drejtor i Departamentit për Zhvillim Strategjik Shëndetësor

Ministria e Shëndetësisë

Email: niman.bardhi@rks-gov.net; nimanbardhi@gmail.com; nimanbardhi@hotmail.com.

Tel. zyre: +383 (0) 38 200 24 105

Tel. mob: +383 (0) 44 352 172; +383 (0) 49 352 172

Organi Propozues	Ministria e Shëndetsisë
Titulli i-Nismës se re	Plani i veprimit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në kujdesin dytësor shëndetësor - 2024
Programi-Nën Programi:	Administrata Qendrore
Qëllimi i Nismës se re	Programi për Vetë-Menaxhim te Pacientëve me DM dhe HTA në Kosovë ka për qëllim qasjen në kontrollin, parandalimin e komplikimeve si dhe përmirësimin e kualitetit te jetesës përmes edukimit dhe monitorimit në distancë. Ky program përfshin në mënyrë aktive pacientët për të menaxhuar më mirë shëndetin e tyre nën monitorimin e vazhdueshem nga profesionistët shëndetësor.

Objektivat

Objektivi 1	Funkcionalizimi i programit të vetë-menaxhimit të pacientëve me diabet dhe hipertension në Spitalin
Objektivi 2	
Objektivi 3	

		Viti 0					Viti 1					Viti 2					Viti 3				
Objektivi 1	Funicionalizimi i programit të vetë-menaxhimit të pacientëve me diabet dhe hipertension në Spitalin e Përgjithshëm Pejë dhe Gjakovë																				
Produkti		Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matese		Sasia			Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matëse		Sasia		
Aktiviteti	Identifikimi dhe perzgjedhja e pacientëve për përfshirjen në program							26,500				0.00					0.00				
Aktiviteti	Trajnimet							18,000				0.00					0.00				
Aktiviteti	Monitorimi dhe vleresimi						0.00	8,000.00													
Aktiviteti							0.00														
Gjithsej sipas viteve		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	52,500.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej për periudhën		Paga dhe Mëditje	0		Mallra dhe Shërbime	0		52500	Komunali	0		Subvencione dhe Transfera	0		Shpenzime kapitale	0					
Produkti		Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matese		Sasia			Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matëse		Sasia		
Aktiviteti							0.00														
Aktiviteti				0.00			0.00		0.00												
Aktiviteti							0.00														
Aktiviteti																					
Gjithsej sipas viteve		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej për periudhën		Paga dhe Mëditje	0		Mallra dhe Shërbime		0		Komunali	0		Subvencione dhe Transfera	0		Shpenzime kapitale	0					
Projekti																					
Produkti		Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matese		Sasia			Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matëse		Sasia		
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Gjithsej sipas viteve		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej për periudhën		Paga dhe Mëditje	0		Mallra dhe Shërbime	0		0	Komunali	0		Subvencione dhe Transfera	0		Shpenzime kapitale	0					
Objektivi 2																					0
Produkti		Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matese		Sasia			Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matëse		Sasia		
Aktiviteti		0.00																			
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Gjithsej sipas viteve		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej për periudhën		Paga dhe Mëditje	0		Mallra dhe Shërbime		0		Komunali	0		Subvencione dhe Transfera	0		Shpenzime kapitale	0					
Produkti		Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matese		Sasia			Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matëse		Sasia		
Aktiviteti		0.00																			
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Gjithsej sipas viteve		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej për periudhën		Paga dhe Mëditje	0		Mallra dhe Shërbime		0		Komunali	0		Subvencione dhe Transfera	0		Shpenzime kapitale	0					
Projekti																					
Produkti		Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matese		Sasia			Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matëse		Sasia		
Aktiviteti		0.00																			
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Gjithsej sipas viteve		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej për periudhën		Paga dhe Mëditje	0		Mallra dhe Shërbime		0		Komunali	0		Subvencione dhe Transfera	0		Shpenzime kapitale	0					
Objektivi 3																					0
Produkti		Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matese		Sasia			Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matëse		Sasia		
Aktiviteti		0.00																			
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Aktiviteti						0.00															
Gjithsej sipas viteve		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej për periudhën		Paga dhe Mëditje	0		Mallra dhe Shërbime		0		Komunali	0		Subvencione dhe Transfera	0		Shpenzime kapitale	0					
Produkti		Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matese		Sasia			Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matëse		Sasia		
Aktiviteti		0.00																			
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Gjithsej sipas viteve		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej për periudhën		Paga dhe Mëditje	0		Mallra dhe Shërbime		0		Komunali	0		Subvencione dhe Transfera	0		Shpenzime kapitale	0					
Projekti																					
Produkti		Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matese		Sasia			Njësia Matëse		Sasia			Njësia Matëse		Sasia		
Aktiviteti		0.00																			
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Aktiviteti																					
Gjithsej sipas viteve		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Mundësitë për kursime

Programi [Nënprogrami]	Kodi	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Total		-			
Paga dhë mëditje		-			
Mallra dhe shërbime		-			
Komunali		-	-	-	-
Subvencione dhe transfere		-	-	-	-
Shpenzime Kapitale		-	-	-	-
[Programi]					
Paga dhe mëditje		-	-	-	-
Mallra dhe shërbime		-	-	-	-
Komunali		-	-	-	-
Subvencione dhe transfere		-	-	-	-
Shpenzime Kapitale		-	-	-	-
[Nënprogrami]		-	-	-	-
Paga dhe mëditje					*0.00*
Mallra dhe shërbime					
Komunali					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime Kapitale					
[Nënprogrami]		-	-	-	-
Paga dhe mëditje				*0.00*	*0.00*
Mallra dhe shërbime					
Komunali					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime Kapitale					
[Nënprogrami]		-	-	-	-
Paga dhe mëditje					
Mallra dhe shërbime					
Komunali					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime Kapitale					
[Programi]			52,500.00		
Paga dhe mëditje			-	-	
Mallra dhe shërbime			*52,500.00*	-	
Komunali		-	-	-	-
Subvencione dhe transfere		-	-	-	-
Shpenzime Kapitale		-	-	-	-
[Nënprogrami]		-	52,500.00	-	-
Paga dhe mëditje					
Mallra dhe shërbime			*52,500.00*		
Komunali					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime Kapitale					
[Nënprogrami]		-	-	-	-
Paga dhe mëditje					
Mallra dhe shërbime					
Komunali					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime Kapitale					
[Nënprogrami]		-	-	-	-
Paga dhe mëditje					
Mallra dhe shërbime					
Komunali					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime Kapitale					
[Programi]					
Paga dhe mëditje		-	-	-	-
Mallra dhe shërbime		-	-	-	-
Komunali		-	-	-	-
Subvencione dhe transfere		-	-	-	-
Shpenzime Kapitale		-	-	-	-
[Nënprogrami]		-	-	-	-
Paga dhe mëditje					
Mallra dhe shërbime					
Komunali					
Subvencione dhe transfere					

Shpenzime Kapitale					
[Nënprogrami]	-	-	-	-	
Paga dhe mëditje					
Mallra dhe shërbime					
Komunali					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime Kapitale					
[Nënprogrami]	-	-	-	-	
Paga dhe mëditje					
Mallra dhe shërbime					
Komunali					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime Kapitale					

Pasqyrë e Financimit të Organizatës Buxhetore/Programit
Korniza Buxhetore Afatmesme (Vlerësimet e Hershme për Periudhën Aktuale)

Përshkrimi	Viti 0 (Buxheti Aktual)	Viti 1 (Vl. e Hershme)	Viti 2 (Vl. e Hershme)
Paga dhe Mëditje	835,275.00	877,038.80	927,038.80
Mallra dhe Shërbime	4,871,619.00	525,319.20	507,905.20
Komunalitë	35,000.00	35,000.00	35,000.00
Subvencione dhe transfere			
Shpenzime kapitale	4,400,000.00	9,000,000.00	2,600,000.00
Gjithsej	10,141,894.00	10,437,358.00	4,069,944.00

Gjithsej kosto e iniciatives se re	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Paga dhe mëditje	-	-	-	-
Mallra dhe Shërbime	-	52,500.00	-	-
Komunali	-	-	-	-
Subencione dhe transfere	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	-	-	-	-
Gjithsej	-	52,500.00	-	-

Burimet e Financimit	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Totali
Buxhet Shtesë nga KAB i Ardhshëm	-	-	-	-	-
Numri I punëtoreve	-	-	-	-	-
Paga dhe mëditje		-	-	-	-
Mallra dhe Shërbime			-	-	-
Komunali	-				
Subvencione dhe Transfere	-				
Shpenzime Kapitale	-				
Partnerët Zhvillimor (donatorët)		52,500.00			52,500.00
Financim nga Huamarrja					-
Tjetër (p.sh. PPP)					-
Gjithsej	-	52,500.00	-	-	52,500.00

Shënime për Financim

Plani i veprimit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në kujdesin dytësor shëndetësor - 2024 | ka një kosto prej shuma prej 52,500€ per aktivitetet : identifikimi dhe përzgjedhja e pacientëve për përfshirjen në program,Sigurimi i pajisjeve dhe softverit për monitorim në distancë të pacienteve me DM dhe HTA,Trajnime,Monitorimi dhe vleresimi etj të cilat aktivitete mbulohen nga donatoret si IHS dhe nuk ka kosto shtes.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Departamenti i Buxhetit-Budzet Department-Budget Departament
Formularët e Vlerësimit të Ndikimit Buxhetor

Organi propozues :	**Ministria e Shëndetsisë**
Titulli i Nismës së Re:	**Plani i veprimit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në kujdesin dytësor shëndetësor - 2024**
Dorëzuar nga:	**Administrata Qendrore**

Qëllimi i Nismes se re:	**Programi për Vetë-Menaxhim te Pacientëve me DM dhe HTA në Kosovë ka për qëllim qasjen në kontrollin, parandalimin e komplikimeve si dhe përmiresimin e kualitetit te jetesës përmes edukimit dhe monitorimit në distancë. Ky program përfshin në mënyrë aktive pacientët për të menaxhuar më mirë shëndetin e tyre nën monitorimin e vazhdueshem nga profesionistët shëndetësor.**

Objektivat e Nismes se re:

Objektivi 1	Funkcionalizimi i programit të vetë-menaxhimit të pacientëve me diabet dhe hipertension në Spitalin e Përgjithshëm Pejë dhe Gjakovë

Treguesit e Efikasitetit të Produkteve:

Produkti	Viti 0			Viti 1			Viti 2			Viti 3		
	Sasia	Njësia Matëse	Kostoja për njësi	Sasia	Njësia matëse	Kostoja për njësi	Sasia	Njësia Matëse	Kostoja për njësi	Sasia	Njësia Matëse	Kostoja për Njësi

Vlerësimet e Hershme për Organin Propozues/Programin sipas KAB-it aktual

	Viti 0	Viti 1	Viti 2
Paga dhe Mëditje	835,275.00	877,038.80	927,038.80
Mallra dhe Shërbime	4,871,619.00	525,319.20	507,905.20
Komunali	35,000.00	35,000.00	35,000.00
Subvencione dhe transfere	-	-	-
Shpenzime Kapitale	4,400,000.00	9,000,000.00	2,600,000.00
Gjithsej	**10,141,894.00**	**10,437,358.00**	**4,069,944.00**

Kostoja totale	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Paga dhe Mëditje	-	-	-	-
Mallra dhe Shërbime	-	52,500.00	-	-
Komunali	-	-	-	-
Subvencione dhe Transfere	-	-	-	-
Kapitale	-	-	-	-
Gjithsej	-	52,500.00	-	-
Burimet e Propozuara të Financimit				
Buxhet Shtesë nga KAB i Ardhshëm	-	-	-	-
Numri i Punetoreve	-	-	-	-
Paga dhe mëditje	-	-	-	-
Mallra dhe Shërbime	-			
Komunali	-			
Subvencione dhe Transfere	-	-	-	-
Shpenzime Kapitale	-	-	-	-
Parnerët Zhvillimor (donatorët)	-	52,500.00	-	-
KAB Ekzistues	-	-	-	-
Paga dhe mëditje		-	-	
Mallra dhe Shërbime		-	-	
Komunali		-	-	-
Subvencione dhe Transfere	-	-	-	-
Shpenzime Kapitale	-	-	-	-
Financim nga Huamarrja	-	-	-	-
Tjetër (p.sh. PPP)	-	-	-	-
Gjithsej	-	52,500.00	-	-
Pjesa pa financim të paraparë	-	-	-	\

Komente shtesë për financim

Plani i veprimit për vetë-menaxhim të pacientëve me diabet dhe hipertension në kujdesin dytësor shëndetësor - 2024 ka një kosto prej shuma prej 52,500€ per aktivitetet : Identifikimi dhe përzgjedhja e pacientëve për përfshirjen në program,Sigurimi i pajisjeve dhe softverit për monitorim në distancë të pacienteve me DM dhe HTA,Trajnime,Monitorimi dhe vleresimi etj të cilat aktivitete mbulohen nga donatoret si IHS dhe nuk ka kosto shtes.

Më: _____

Zyrtari Kryesor Financiar	Zyrtari Kryesor Administrativ	Ministri/Kreu i Organizatës
Nënshkrimi	Nenshkrimi	Nenshkrimi